



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

URDHËR

Nr. 688, datë 04.06 2024

PËR  
MIRATIMIN E PROGRAMIT DHE KALENDARIT VJETOR TË TRAJNIMIT TË ASHK PËR  
VITIN 2024


Në mbështetje të gërmës c), të pikës 2, të nenit 9 të Ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr.513, datë 05.03.2024 ”Për ngritjen dhe organizimin e njësisë së trajnimeve në ASHK”, në vijueshmëri të kërkesave dhe nevojave të kohës, me qëllim rritjen e performancës së punonjësve të ASHK-së dhe unifikimit të procesit të trajnimit të vazhdueshëm dhe përmirësimit të aktivitetit në zbatim të legjislacionit për çështjet e pronësisë;

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit dhe Kalendarit vjetor të trajnimit të ASHK për vitin 2024”, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen për zbatimin e saj, të gjitha Njësitë në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, drejtoritë vendore të saj, trajnerët e brendshëm, si dhe pjesëmarrësit në trajnime.
3. Ngarkohet me publikimin e saj në faqen zyrtare të ASHK-së, Drejtoria e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve.
4. Kjo urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

DALLËNDYSHE BICI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHETTËTORRE E KADASTRËS

(SHTOJCA 1)

PROGRAMI DHE KALENDARI VJETOR I TRAJNIMIT NË ASHK PËR VITIN 2024

NR	TEMA	Afati i planifikuar për përmbushjen e objektivit	DVASHK/Strukturat që do të trajnohen
FUSHA	LEGJISLACIONI PËR KADASTRËN(LIGJI NR.111/2018)- LEGJISLACIONI PËR PROCESET KALIMTARE TË PRONËSISË NË RSH ( LIGJI NR.20/2020)		
1.	Rregullat dhe procedurat e lëshimit të akteve të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore në zbatim të ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH" dhe VKM nr.1182/2020	Prill 2024	DVASHK (Shkodër)
2.	Mbi përdorimin e sistemit ALBSCAD, përmirësimet dhe përditësimet, mënyra e ruajtjes së të dhënave, etj.	Prill-Maj 2024	DVASHK
3.	Mbi rregullat dhe procedurat e regjistrimit fillestar dhe përmirësimin të regjistrimit kadastral, në zbatim të ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën" dhe VKM nr.4, datë 11.01.2023 dhe akteve të tjera të brendshme që rregullojnë fushën.	Maj 2024	QKD
4.	Procedurat mbi përfundimin e proceseve kalimtare administrativo-ligjore të trajtimit të pasurive të paluajtshme në zbatim të ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij (objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe të oborreve në përdorim, përditësimin të listave të pronave shtetërore, regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, etj)	Qershor 2024	DVASHK (Sektori i Evidencimit Invetarizimit & Transferimit të Pronës Shtetërore/Sektori i Legalizimit Çështjeve të Pronësisë & Proceseve Hartografike/ Sektori i Regjistrimit të Shërbimeve të Kadastrës)

5.	<p>Trajnimi i pikave të kontaktit të Bashkëqeverisjes pranë Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- për ti dhënë zgjidhje gëshëve/rasteve që vijnë në seksionet e platformës “Me ty për procedurat ose parashikimet ligjore përkatëse, nuk kanë marrë nga institucioni publik informacionin apo shërbimin publik të kërkuar.</li> <li>- për të garantuar përfundimin e shërbimeve ndaj çdo shtetasi, nëpërmjet procedurave administrative të thjeshta dhe transparente, brenda afatave të parashikuara në ligj.</li> <li>- për të orientuar pikat e kontaktit të Bashkëqeverisjes për rastet që i adresohen platformës nuk janë ankesa, por gëshjet lidhen me ankime administrative dhe duhet të parashtrihen me shkrim përmes postës në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurave Administrative.</li> </ul>	Qershor 2024	DVASHK
6.	<p>Zbatimi i kriterëve të legalizimit, përcaktimi i dokumentacionit dhe rregullave të hollësishtme të evidentimit të ndërtimeve pa leje, procedura dhe afatet, mënyra e plotësimit të akteve (skicë fushore, akt evidentimi, genplan dhe planimetrisë, vendim legalizimi, etj), si dhe regjistrimi në regjistrat e pasurive të paluajtshme i aktit administrativ vendim legalizimi, sipas parashikimeve të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” dhe VKM nr. 1040/2020 dhe VKM nr. 1178/2020, etj.</p>	Qershor 2024	DVASHK (Sektori i Legalizimit Çështjeve të Pronësisë dhe Proceseve Hartografike)
7.	<p>Rregullat mbi mënyrën e përlogaritjes së tatimit mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme sipas parashikimeve të Ligjit nr. 29/2023, datë 30.03.2023”, “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe Udhëzimit të Përbashkët nr.34, datë 29.12.2023, Për tatimin mbi të ardhurat nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme”</p>	Korrik 2024	DVASHK
8.	<p>Regjistrimi i titujve të pronësisë në zbatim të nenit 193 të Kodit Civil dhe parashikimeve të Ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, mënyra e plotësimit të të dhënave të akteve kadastrale (<i>Certifikatës së pronësisë, Vërtetimit pronësie, Kartelën e pasurisë së paluajtshme, harta kadastrale, Kërkesat për plotësim dokumentacioni, vendim/urdhër refuzimi, etj</i>), procedura e regjistrimit dhe kompetencat e refuzimit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 111/2018” Për Kadastrën”, VKM nr. 782/2020, dhe akteve të tjera në fuqi që mbulojnë fushën.</p>	Shtator 2024	DVASHK (Sektori i Regjistrimit & Shërbimeve të Kadastrës)

9	Mbi procedurat e regjistrimit të titujve të pronësisë që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen sipas parashikimeve të ligjit nr. 111/2018 “ Për Kadastrën” dhe VKM nr.781/2020	Tetor 2024	DVASHK (Sektori i Regjistrimit & Shërbimeve të Kadastrës)
10	Mbi regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje për efekt regjistrimi në zbatim të VKM nr.329/2019	Nëntor 2024	DVASHK (Sektori i Regjistrimit & Shërbimeve të Kadastrës)